



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

DEKLARATË PËR SHTYP

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka rihapur thirrjen për aplikime të Skemës Kombëtare për masat mbështetëse nr. 44, 45 në Agroturizëm dhe Bujtina.

Bazur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 22 dhe Udhëzimin Nr.11 të firmosur nga Ministrat Peleshi dhe Ahmetaj janë reflektuar ndryshimet e mëposhtme:

MASA MBËSHTETËSE NR. 44 jep mbështetje për ngritjen apo rikontruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural (bujtina) me kapacitet nga **4 deri 10 dhoma** në 50% te investimit me masë financimi deri në **një milion e pesëqind mijë Lekë**.

MASA MBËSHTETËSE NR. 45 jep mbështetje për ndërtim apo rikonstruksion strukturash agroturistike deri në 50% të investimit me masë financimi **deri në dhjetë milion Lekë**.

Nëpërmjet kësaj skeme është vënë në dispozicion një buxhet prej 122 milionë Lekë për masën 45, ku parashikohen minimumi 12 aplikime fituese, të cilat do të rezultojnë në investime agroturizmi serioze në zonat rurale.

Gjithashtu, një buxhet prej 32 milionë Lekë është alokuar për masën 44, ku parashikohet ngritja ose rikonstruksioni i minimum 22 bujtinave.

Skema ka për qëllim të mbështesë aktivitete agroturizmi, të cilat demonstrojnë më së miri një qasje origjinale të identitetit të zonës, duke respektuar arkitekturën dhe estetikën, si dhe pasqyrimin e aktiviteteve mbështetëse që ndikojnë në rivitalizimin e fshatit dhe të kthehen në një arsye për të rritur numrin e vizitorëve.

Synohet zhvillimi rural duke shfrytëzuar burimet natyrore dhe bukuritë që ofron vendi me potencial të lartë për të gjeneruar një ekonomi lokale të konsoliduar dhe të qëndrueshme.

Projektet fituese janë ato investime që kryejnë veprimtari mikpritëse, që zhvillohen në një fermë bujqësore apo në një veprimtari tjetër agrikulurore, me qëllim tërheqjen e vizitorit ndaj cilësisë së prodhimeve dhe përpunimeve autentike të fermës, ushqimit, arkitekturës dhe karakteristikat specifike të zonës.

Përfituesit potencialë të kësaj skeme janë fermerë, persona fizik ose juridik, të cilët duhet të paraqesin pranë AZHBR, dosje fizike me dokumentacionin përkatës, sipas Udhëzimit Nr. 11 Dt. 21.6. 2018, i cili gjendet i detajuar në faqen e internetit të AZHBR, azhbr.gov.al

Projektet duhet të përfshijnë:

- Pjesën konstruktive, arkitekurore të shoqëruar me një relacion teknik nga arkitekti.
- Nje plan biznesi të qenësishëm 5 - vjeçar
- Të përmbushë standardet e akomodimit dhe mbrojtjes mjedisore si dhe sigurinë ushqimore
- Të ketë përmbushur detyrimet tatimore për personat fizikë dhe juridikë
- Ndersa për aplikuesit fermerë të kenë shlyer sigurimet shoqërore

Në përfundim të investimit subjektet fituese duhet të sigurojnë çertifikatën e agroturizmit sipas VKM për agroturizmin

AZHBR fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë në këto dy masa mbështetëse deri më 15 Korrik, 2018 duke dorëzuar dosjet fizike, pranë zyrave qendrore të AZHBR.

Aplikimet e reja te hapura në sektorin e Agroturizmit, janë mundësi shumë e mirë për të gjitha ato agrobiznese që dëshirojnë të diversifikojnë veprimtarinë e fermave të tyre, duke rritur jo vetëm ekonominë familjare, por edhe atë të komunitetit në tërësi, me rritje në punësim, gjetje të reja inovative dhe të veçanta për tregun shqiptar, që në nivel ekonomik do japin impakt pozitiv në përmirësimin e jetesës së zonave rurale, si edhe në ekonominë e vendit.